



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË
PRISHTINË

Pranuar me: 20.06.2022			
Nj. org.	Numer	Shtolca	Vicia
03	3555	2	-

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

Fakulteti

Fakulteti i Filologjisë - Departamenti i Gazetarisë

Lëndët

Histori e gazetarisë evropiane,
komunikim strategjik, Intervista & Talkshou

Kandidatët e paraqitur

1. Blerta Aliu
2. Kaltrina Jashari
3. Arbenita Hoxha – Ramaj
4. Hyrije Mehmeti
5. Gentiana Paçarizi
6. Hana Marteti
7. Pranvera Gashi

Komisioni vlerësues

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof.ass.dr. Alban Zeneli
Prof.ass.dr. Gëzim Qerimi
Prof.ass.dr. Muhamet Jahiri



SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE

DEPARTAMENTI I GAZETARISË

III.2. asistent për lëndët: Histori e gazetarisë evropiane, Komunikim strategjik, Intervista & Talkshou

Në konkurs janë paraqitur kandidatët: Arbenita Hoxha – Ramaj, Blerta Aliu, Gentiana Paçarizi, Hyrije Mehmeti, Hana Marteti, Pranvera Gashi, Kaltrina Jashari

Propozohet:

MA Hyrije Mehmeti (lindur më: 23.08.1992), ka konkuruar për pozitën numër 2 të Kapitullit III, të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakultetin e Filologjisë-Departamentin e Gazetarisë, me notën mesatare 9.56. Mehmeti, i ka përfunduar studimet Master në të njëjtin departament të Universitetit të Prishtinës, me notën mesatare 9.07. Mehmeti ka punuar në medie të ndryshme të Kosovës dhe ka përvojë në fushën e mësimdhënies. Kandidatja në fjalë **propozohet** në këtë pozitë të këtij konkursi.

Refuzohen:

MA Arbenita Hoxha – Ramaj, (lindur më: 15.09.1991) ka konkuruar për pozitën numër 2 të Kapitullit III, të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gazetarisë, me notën mesatare 9.43. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në të njëjtin Departament me notën mesatare 9.00. Kandidatja në fjalë ka dorëzuar dëshmi për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme universitare dhe trajnime që lidhen me fushën e mediave. Hoxha – Ramaj ka qenë e angazhuar edhe më parë në Departamentin e



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Gazetarisë në cilësinë e asistentes së angazhuar. Kandidatja Hoxhaj – Ramaj, nuk propozohet në këtë pozitë, sepse është propozuar për një pozitë tjetër të këtij konkursi.

MA Blerta Aliu (lindur më: 08.03.1990), ka konkuruar për pozitën numër 2 të Kapitullit III, të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakultetin e Filologjisë-Departamentin e Gazetarisë, me notën mesatare 9.10. Aliu, i ka përfunduar studimet Master në të njëjtin departament të Universitetit të Prishtinës, me notën mesatare 9.23. Kandidatja e cekur më lartë ka qenë asistente e angazhuar në Departamentin e Gazetarisë, si dhe ka qenë pjesëmarrëse në aktivitete të ndryshme universitare të organizuara nga Departamenti i Gazetarisë. Aliu gjithashtu ka ushtruar profesionin e gazetarisë për katër vite në gazetën ditore “Koha Ditore” (2011-15). Kandidatja në fjalë nuk propozohet në këtë pozitë, sepse është propozuar për një pozitë tjetër në këtë konkurs.

MA Gentiana Paçarizi (lindur më: 12.09.1993), ka konkuruar për pozitën numër 2 të Kapitullit III, të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakultetin e Filologjisë-Departamentin e Gazetarisë, me notën mesatare 9.84. Paçarizi, i ka përfunduar studimet Master në të njëjtin departament të Universitetit të Prishtinës, me notën mesatare 9.64. Kandidatja e cekur më lartë ka qenë asistente e angazhuar për një vit në Departamentin e Gazetarisë dhe ka përvojë në fushën profesionale të gazetarisë. Aktualisht Paçarizi, sipas të dhënave në biografinë e dorëzuar është në marrëdhënie punë në dy institucione: Redaktore menaxhuese në KOSOVO 2.0, menaxhere projekti në New Perspektiva. Kandidatja Gentiana Paçarizi nuk i plotëson kriteret formale për angazhim, sepse bie në kundërshtim me pikën 9, të Nenit 7, të Rregullorës së Procedurave për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, nr.prot: 1/95, të datës 24.06.2021, në të cilin specifikohet: “Në Universitetin e Prishtinës nuk mund të angazhohen kandidatët, të cilët kanë më tepër se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune apo honorar në institucionet publike apo private me pagë primare apo sekondare”. Duke u bazuar në këtë nen të rregullorës në fjalë, kandidatja Gentiana Paçarizi nuk propozohet për këtë pikë të konkursit.

MA Hana Marteti, (lindur më: 08.04.1994.) ka konkuruar për pozitën numër 2 të Kapitullit III, të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gazetarisë, me notën mesatare 8.35. Ka përfunduar gjithashtu studimet



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Master në të njëjtin Departament më notën mesatare 8.14. Kandidatja në fjalë ka përvojë profesionale në fushën e gazetarisë. Kandidatja Marteti nuk propozohet, sepse kundërkandidatja e propozuar ka notë mesatare me të lartë dhe përvojë në mësimdhënie universitare.

MA Pranvera Gashi, (lindur më: 22.03.1993) ka konkuruar për pozitën numër 2 të Kapitullit III, të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gazetarisë, me notën mesatare 8.23. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në të njëjtin Departament më notën mesatare 8.64. Kandidatja në fjalë ka përvojë profesionale në fushën e gazetarisë. Kandidatja Gashi nuk propozohet, sepse kundërkandidatja e propozuar ka notë mesatare me të lartë dhe përvojë në mësimdhënie universitare.

MA Kaltrina Jashari (lindur më: 29.06.1997), ka konkuruar për pozitën numër 2 të Kapitullit III, të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakultetin e Filologjisë, Departamentin e Gazetarisë, me notën mesatare 9.47. Jashari, i ka përfunduar studimet Master në të njëjtin departament të Universitetit të Prishtinës, me notën mesatare 9.53. Jashari, ka përvojë në fushën e gazetarisë. Kandidatja në fjalë nuk propozohet në këtë pozitë, sepse është propozuar për një pozitë tjetër.

Prishtinë, 20 qershor 2022

Komisioni vlerësues

4. Kryetar
5. Anëtar
6. Anëtar

Prof.ass.dr. Alban Zeneli

Prof.ass.dr. Gëzim Qerimi

Prof.ass.dr. Muhamet Jahiri